**Nr.** 572/1 **Prot.** **Elbasan më** 16.5**.2024**

**Lënda:** Konfirmim Akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**
Adresa:Lagjja "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa, Elbasan

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në lidhje me ligjshmërinë e vendimit tuaj nr.43 datë 30.04.2024 "Mbi shpërndarjen e fondit financiar të mbrojtjes civile të vitit 2024 për 30 familjet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore dhe dhënien e ndihmës financiare nga ana e Bashkisë Elbasan (në shumën 6,539,312 lekë) ", pasi verifikuam dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor të parashikuar në V.K.M Nr. 329 datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Majlinda PERRIU**

541
03.05.2024

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. 2078/1. Prot.** **Elbasan, më 02.4.2024**

**VENDIM**

**Nr. 44 datë 30.4.2024**

***"Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2024"***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës 30.4.2024, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Klubi Shumësportesh i Bashkisë Elbasan *"Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2024"*, mbështetur në:

a) Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
b) Ligjin nr. 79/2017 "Për sportin" (i ndryshuar);
c) Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ekipet sportive dhe trajnerët përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2024, si mëposhtë:

| *Nr.* | *Disiplinat Sportive / Ekipet* | *Trajneri* | *Nr. i sportistëve* |
|---|---|---|---|
| | **VOLEJBOLL** | | **28** |
| 1 | Të Rritur | 1 | 14 |
| 2 | Të Rinj | 1 | - |
| 3 | Të Rritura | 1 | 14 |
| 4 | Të Reja | 1 | - |
| | **BASKETBOLL** | | **24** |
| 5 | Të Rritur | 1 | 12 |
| 6 | Të Rinj | 1 | - |
| 7 | Të Rritura | 1 | 12 |
| 8 | Të Reja | 1 | - |
| | **HENDBOLL** | | **7** |
| 9 | Të Rritur (M) | 1 | 7 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **NOT** | | **3** |
| 32 | Meshkuj & Femra | 1 | 3 |
| | **SHAH** | | |
| 33 | Meshkuj | - | - |
| | **RAFTING** | | |
| 34 | Meshkuj | - | - |
| | **HARK** | | |
| 35 | Meshkuj | - | - |

2. Ngarkohen Klubi Shumësportesh, Drejtoria e Buxhet - Financës në Bashkinë Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**
**Elvi Çuni**

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

*Konceptoi:*

*Përgjegjësi i Sektorit të Klubit Shumësportesh:* *M. Backa*

*Pranoi:*

*Drejtori i Klubit Shumësportesh:* *A. Kovaçi*

*Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Informacionit:* *A. Hoxha*

*Miratoi:*

*Drejtori i Drejt. Prgjthsh. Ardh. Buxh. e Fin.:* *G.Dyrmyshi*

*Konfirmoi:*

*Zv/kryetari:* *A. Sula*

*Zv/kryetari:* *A. Bylykbashi*

2078/2
08.05.2024.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA**

Nr. 541/1 prot.

Elbasan, më 8.5.2024

**Lënda:** Konfirmim Akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.44 datë 30.04.2024, "Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportësh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2024", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Majlinda PERRIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Adresa: Lagjia "Brig.17 Sulmuese", Rruga "Q.Stafa", Tel: 054 252138, www.prefektielbasan.gov.al, prefekti.elbasan@mb.gov.al

542
03.05.2024

14

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

**Nr.** 2137/1 **Prot.** **Elbasan, më:** 02.05.2024.

# V E N D I M

**Nr.** 45 **Datë:** 30 **.04.2024.**

***"Mbi miratimin e fillimit të proçedurave për përditësimin dhe kalimin në pronësi të pasurive me emërtimin "Shtëpia muze e "Aleksandër Xhuvanit" e "Shtëpia muze e "Lef Nosit", dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan".***

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, ligjin Nr. 8744, datë 22.01.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajsthsme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar; ligjin nr. 111/2018 *"Për Kadastrën"*; ligjin nr. 20/2020 *"Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*; V.K.M nr. 28 datë 27.01.2023 *"Për përcaktimin e proçedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve"*; V.K.M. nr. 416 datë 11.07.2007 *"Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit"*, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30 .04.2024 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore:

## V E N D O S I :

1. Miratimin për fillimin e proçedurave për përditësimin dhe kalimin në pronësi të pasurive me emërtimin "Shtëpia muze e "Aleksandër Xhuvanit" e "Shtëpia muze e "Lef Nosit", dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan".
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e proçedurës së mëtejshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**Lutfi Lala**

**SEKRETARI**

**Elvi Cuni**

*Konceptoi: A. Braneshi* *A. Pisha*
*Drejtoria P.P.:* *A. Suli*
*Drejtoria F.B.:* *A. Merkja*
*Drejtoria P:* *M. Avllazagaj*
*Drejtoria D.P.Zh.T* *A. Muhametaj*
*Drejtoria e P.P.ZH.U.SH.I:* *D. Meta*
*Drejtoria J. I:* *A. Hoxha*
*Zv/Kryetar:* *A. Bylykbashi*

Miratuar me ______ vota

Vota Pro _____

Vota kundër _____

Vota Abstenim_____

Zbardhur më datë_____/_____/2024

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI :SHTET　　DATE 23.01.2024　　QELLIMI:REGJISTRIM PASURIE

VENDNDODHJA
BASHKIA ELBASAN , L.KALA　　DVASHK/ZVASHK_____　　ZONA KADASTRALE 8524　　NUMRI PASURISE 12/153 ,12/15　　INDEX HARTE EL;(L-8)
V. 99　F.99

TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE Truall　　SIP.PASURISE= 625m2　　SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=195 m2 Ndertese 1 kat +bodrum 140m2　　NUMRI PEMEVE_______

X=506767.619
Y=4553505.380

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=506865.119
Y=4553505.380




SHPJEGUES
KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE
SIPERFAQE =625m2
NDERTESE
SIPERFAQE =195m2

X=506767.619
Y=4553440.880

SH 1:500

X=506865.119
Y=4553440.880

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | | PAS nr.12/1 | | |
| 2 | JUGE | | | PAS nr.12/50 | | SHTEPIA MUZE "ALEKSANDER XHUVANI" |
| 3 | LINDJE | | | PAS nr.12/68, 12/24 | | |
| 4 | PERENDIM | | | PAS nr.12/14 ,12/152 | | |

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
GLEDIAN LLATJA

REALIZOI PER BASHKINE ELBASAN
GRUPI I PUNES
ASHK Ing .MENTOR TOLA　Mentor Tola　Digitally signed by Mentor Tola Date: 2024.04.17 15:21:21 +02'00'
Ark. VALBONA LUFTA　Valbona Lufta　Digitally signed by Valbona Lufta Date: 2024.04.18 09:49:37 +02'00'
Ing. GENTIANA KERRI　Gentiana Kerri　Date: 2024.04.18

MIRATOI PER ASHK
DREJTORI DVASHK
ADI QOSE　Adi Qose　Digitally signed by Adi Qose Date: 2024.04.17 16:05:40 +02'00'
NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:__________
Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:__________
Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

ESHTE POZICIONUAR SIPAS FAKTIT SHTEPIA MUZE "ALEKSANDER XHUVANI" E CILA FIGURON PASURI SHTET DHE DO KALOJE NE PRONESI TE BASHKISE ELBASAN.

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI__SHTET(SHTEPIA MUZE "ALEKSANDER XHUVANI")
NENSHKRIMI _______

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

Gledian Llatja　Digitally signed by Gledian Llatja Date: 2024.04.23 12:30:30 +02'00'

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

**PRONARI : SHTET** DATE 23/01/2024 QELLIMI:REGJISTRIM PASURIE

VENDNDODHJA
BASHKIA ELBASAN , L.KALA DVASHK/ZVASHK ELBASAN ZONA KADASTRALE ZK.8524 NUMRI PASUR 13/92 Vol.30 F.143 INDEX HARTE EL;(M-8)
TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE TRUALL SIP.PASURISE=545.3m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT =156 m2 2kat +bodrum NUMRI PEMEVE_____

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=506743.990
Y=4553334.957

X=506841.490
Y=4553334.957




X=506743.990
Y=4553270.457

**SH 1:500**

X=506841.490
Y=4553270.457

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | | V-PAS. 13/175-nd, 13/182 | | "SHTEPIA E LEF NOSIT " |
| 2 | JUGE | | | J-PAS. 13/321 | | |
| 3 | LINDJE | | | L-PAS. 13/91 | | |
| 4 | PERENDIM | | | P-PAS. 13/93 ,13/94-nd | | |

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
GLEDIAN LLATJA

REALIZOI PER BASHKINE ELBASAN
GRUPI I PUNES
ASHK Ing .MENTOR TOLA
Ark. VALBONA LUFTA
Ing. GENTIANA KERRI

Mentor Tola
Digitally signed by Mentor Tola Date: 2024.04.17 15:20:19 +02'00'

MIRATOI PER ASHK

DREJTORI DVASHK
ADI QOSE

NENSHKRIMI / VULA _______

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:__________

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:__________

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

ESHTE POZICIONUAR SIPAS FAKTIT OBJEKTI I SHTEPISE MUZE "LEF NOSI" E CILA FIGURON PASURI SHTET DHE DO KALOJE NE PRONESI TE BASHKISE ELBASAN.

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI "SHTEPIA E LEF NOSIT "

NENSHKRIMI _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

Adi Qose
Digitally signed by Adi Qose Date: 2024.04.17 16:05:40 +02'00'

Gledian Llatja
Digitally signed by Gledian Llatja Date: 2024.04.23 12:30:30 +02'00'

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

**PRONARI : SHTET** | **DATE 23/01/2024** | QELLIMI:REGJISTRIM PASURIE

| VENDNDODHJA | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| BASHKIA ELBASAN , L.KALA | DVASHK/ZVASHK ELBASAN | ZONA KADASTRALE ZK.8524 | NUMRI PASUR 13/94, 13/94-ND | Vol.19 F.166 | INDEX HARTE EL;(M-8) |
| TE DHENAT E PASURISE | | | | | |
| LLOJI PASURISE GODINE | | SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT = 39.2m2 1kat | | | NUMRI PEMEVE______ |

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=506743.990
Y=4553334.957

X=506841.490
Y=4553334.957




X=506743.990
Y=4553270.457

**SH 1:500**

X=506841.490
Y=4553270.457

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | | V-PAS. 13/175-ND | | |
| 2 | JUGE | | | J-PAS. 13/93 | | |
| 3 | LINDJE | | | L-PAS. 13/92 | | |
| 4 | PERENDIM | | | P-PAS. 13/333 | | |

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
GLEDIAN LLATJA

REALIZOI PER BASHKINE ELBASAN
GRUPI I PUNES
ASHK Ing .MENTOR TOLA
Ark. VALBONA LUFTA
Ing. GENTIANA KERRI

Mentor Tola — Digitally signed by Mentor Tola Date: 2024.04.17 15:31:21 +02'00'

MIRATOI PER ASHK
DREJTORI DVASHK
Adi Qose

Gentiana Kerri — Digitally signed by Gentiana Kerri Date: 2024.04.18 09:42:33 +02'00'

Valbona Lufta — Digitally signed by Valbona Lufta Date: 2024.04.18 09:49:37 +02'00'

NENSHKRIMI / VULA_______

Adi Qose — Digitally signed by Adi Qose Date: 2024.04.17

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:___________

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:___________

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PASURIA ME NR. 13/94 FIGURON SHTET DHE DO KALOJE NE PRONESI TE BASHKISE ELBASAN.

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI______ NUMRI PASURISE 13/94 ME PRONAR SHTET.

NENSHKRIMI ______

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

Gledian Llatja — Digitally signed by Gledian Llatja Date: 2024.04.23 12:30:30 +02'00'

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

**PRONARI : SHTET** | DATE 23/01/2024 | QELLIMI:REGJISTRIM PASURIE

VENDNDODHJA
BASHKIA ELBASAN , L.KALA | DVASHK/ZVASHK ELBASAN | ZONA KADASTRALE ZK.8524 | NUMRI PASUR 13/93 | Vol.30 F.119 | INDEX HARTE EL;(M-8)

TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE TRUALL | SIP.PASURISE=63.9m2 | SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT =63.9 m2 1kat | NUMRI PEMEVE_______

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=506743.990
Y=4553334.957

X=506841.490
Y=4553334.957




X=506743.990
Y=4553270.457

**SH 1:500**

X=506841.490
Y=4553270.457

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | | V-PAS. 13/94 | | |
| 2 | JUGE | | | J-PAS. 13/321 | | |
| 3 | LINDJE | | | L-PAS. 13/92 | | |
| 4 | PERENDIM | | | P-PAS. 13/333 | | |

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
GLEDIAN LLATJA

REALIZOI PER BASHKINE ELBASAN
GRUPI I PUNES
ASHK Ing .MENTOR TOLA
Ark. VALBONA LUFTA
Ing. GENTIANA KERRI

MIRATOI PER ASHK
DREJTORI DVASHK
ADI QOSE

NENSHKRIMI / VULA _______

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:___________

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:___________

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PASURIA ME NR. 13/93 E LLOJIT TRUALL FIGURON SHTET DHE DO KALOJE NE PRONESI TE BASHKISE ELBASAN.

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI_____ NUMRI PASURISE 13/93 ME PRONAR SHTET.

NENSHKRIMI _______

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

Adi Qose — Digitally signed by Adi Qose Date: 2024.04.17 16:05:40 +02'00'

Gledian Llatja — Digitally signed by Gledian Llatja Date: 2024.04.23 12:30:30 +02'00'

2137/2
13.05.2024.


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**


Nr. 5421/1 prot. Elbasan, më 10.5.2024

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.45 datë 30.04.2024 "Për mbi miratimin e fillimit të proçedurave për përditësimin dhe kalimin në pronësi të pasurive me emërtimin "Shtëpi muze e "Aleksandër Xhuvanit" e "Shtëpi muze e "Lef Nosit" dhe regjistrimin e tyre në emër të Bashkisë Elbasan" konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Majlinda PERRIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

543
03.05.2024

15

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**Këshilli Bashkiak**

**Nr.** 2172/1 **Prot.** **Elbasan, më** 02 . 05 **. 2024**

**Vendim**
**Nr** 46 **Datë** 30 / 04 **/2024**
**Mbi miratimin e marrëveshjes midis Bashkisë Elbasan dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 30 / 04 /2024, pasi shqyrtoi marrëveshjen me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit mbi vjeljen e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake në qarkullimin rrugor dhe relacionin e paraqitur nga administrate e Bashkisë, bazuar në ligjin 139/2015 Për vetqeverisjen vendore" nenet 8, 9, 10, 23, 29 e 54 të tij, ligjin 8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i R.SH." i ndryshuar,

**Vendosi**

1. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në lidhje me evidentimin dhe vjeljen e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake në qarkullimin rrugor, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Kryetari e administrata e Bashkisë, dhe Policia Bashkiake me zbatimin e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

*Përgj. Sek. Transp.* *E. Bordi*
*Përgj. Sek. IT.* *E. Hoxha*
*Drejt. Juridike* *A. Hoxha*
*Drejt. Buxhet-Finance* *A. Merkja*

**Sek. Këshillit Bashkiak**
**Elvi Çuni**

**Kryetari**
**Lutfi Lala**

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q. Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al ëeb:ëëë.elbasani.gov.al*

MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E POLICISË SË SHTETIT
Nr.7379/1 Prot., datë 12.10.2023
/35

BASHKIA ELBASAN
Nr.9684/1 Prot., datë 6.10.2023
/1

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TE POLICISË SË SHTETIT

DHE

BASHKISË ELBASAN

"PËR

VJELJEN E DETYRIMEVE TË PASHLYERA NGA KUNDËRVAJTJET RRUGORE DHE KONVERTIMIN E KËTYRE VLERAVE MONETARE NË INVESTIM PËR POLICINË E SHTETIT"

Sot, më datë __.__.2023, në Tiranë, lidhet kjo marrëveshje ndërmjet:

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT (DPPSH)**, me adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, **Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU**, në vijim cilësuar si "Policia e Shtetit";

**BASHKISË ELBASAN**, me adresë: Rruga "Qemal Stafa", Elbasan, përfaqësuar nga **Kryetari Z. Gledjan LLATJA**, në vijim cilësuar si "Bashkia";

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Bashkia Elbasan në vijim cilësuar edhe si Palët, bien dakord për sa vijon:

**Neni1**

**Objekti dhe qëllimi**

1. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi mes Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake, me qëllim disiplinimin e qarkullimit rrugor, evidentimin dhe vjeljen e detyrimeve të pashlyera, që rrjedhin nga kundërvajtjet rrugore të konstatuara në mungesë, si dhe konvertimin e tyre në investime për Policinë e Shtetit.
2. Marrëveshja synon të sigurojë dhënien e aksesit të pjesshëm dhe përdorimit të sistemit E-Gjoba për strukturat e Policisë Bashkiake.

**Neni 2**

**Baza Ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në ligjin nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, ligjin nr. 8224/1997 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës", i ndryshuar, nenin 203 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

**Neni 3**

**Të drejtat dhe detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit**

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka këto të drejta dhe detyrime:

1. Merr përsipër të lejojë akses të pjesshëm të sistemit E-Gjoba për strukturat e Policisë Bashkiake, në funksion të pasqyrimit të kundërvajtjeve rrugore;
2. Nëpërmjet strukturave të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit (DTI), në Policinë e Shtetit, merr përsipër të ofrojë suport teknik për Policinë Bashkiake, për sistemin E-Gjoba;

3. Kontrollon përdorimin e të dhënave në bazën e të dhënave të sistemit E-Gjoba, nga përdoruesit e Bashkisë Elbasan;
4. Cakton një pikë kontakti për administrimin e kërkesave të Bashkisë Elbasan për dhënien e aksesit në sistemin e-gjoba.
5. Njofton zyrtarisht Bashkinë Elbasan për pikën e kontaktit të përcaktuar dhe në vijimësi, njofton nëse për arsye objektive vendos ndryshimin e pikës së kontaktit.

**Neni 4**

**Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë Elbasan**

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, Bashkia Elbasan ka këto të drejta dhe detyrime:

1. Policia Bashkiake do të ketë akses të pjesshëm në sistemin E-gjoba, e cila do të përcaktohet me modulet përkatëse.
2. Njofton në rrugë zyrtare Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për heqjen e aksesit në sistemin E-Gjoba, për çdo punonjës që transferohet apo largohet nga detyra.
3. Cakton një pikë kontakti, e cila inicion komunikimet sipas nevojave me pikën e kontaktit në Policinë e Shtetit.
4. Bashkia Elbasan, referuar ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenit 203/3 të Kodit Rrugor, do të përkthejë në investim për Policinë e Shtetit 25% të vlerës së gjobave të arkëtuara për llogari të buxhetit të Policisë Bashkiake. Kjo përqindje e dakordësuar nga strukturat përgjegjëse respektive do t`i kalojë Policisë së Shtetit në forma investimi, kryesisht në fushën TIK, sipas kësaj marrëveshje.
5. Shërbimet e përkthyera në investime, sipas pikës 4 të këtij neni, do të përfshijnë zërat e mëposhtëm, si dhe nevoja të tjera të përcaktuara nga Policia e Shtetit:
   a. Tableta dixhitale për punonjësit e Policisë Rrugore;
   b. Pajisjen me monitorë dhe me aksesorët e nevojshëm për shërbimet e Policisë Rrugore;
   c. Servera dhe pajisje aktive rrjeti, sipas nevojave të sistemit E-Gjoba.
   d. Kamera/Radar në funksion të rritjes së sigurisë në rrugë.

## Neni 5

### Bashkërendimi i punëve ndërmjet palëve

1. Palët marrin masa dhe të sinjalizojnë në lidhje me kundërvajtjet rrugore të palikuiduara të konstatuara ndaj subjekteve gjatë kontrollit të tyre.
2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, palët njoftojnë me shkresë zyrtare pikat kontaktit (emër, e-mail, nr. telefoni).
3. Komunikimi mes palëve për hapjen, mbylljen, ndryshimin e aksesit apo çështjet teknike do të realizohet nëpërmjet postës elektronike ose me shkrim.

## Neni 6

### Kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 2 (dy) vjeçare duke filluar nga data e nënshkrimit të saj, me të drejtë ndryshimi të kohëzgjatjes, me dakordësinë e të dy palëve.

## Neni 7

### Konfidencialiteti

1. Të dhënat e mbledhura në kuadrin e kësaj marrëveshje konsiderohen konfidenciale sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Punonjësit e secilës Palët ruajnë konfidencialitetin për të gjitha të dhënat e siguruara nga sistemi E-Gjoba, gjatë dhe pas përfundimit të detyrës.
3. Të gjitha të dhënat dhe informacioni i siguruar nuk mund të përdoret për qëllime të tjera jashtë përcaktimeve të kësaj marrëveshjeje.

## Neni 8

### Dispozitat e fundit

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi që nga data e nënshkrimit të saj;

2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që ka për objekt detyrimet e palëve të bëhet me mirëkuptim midis tyre;
3. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet me pëlqimin me shkrim të Palëve. Një ndryshim i tillë do të zbatohet për aktivitetet në zbatim, përveç se nëse është rënë dakord ndryshe nga Palët;
4. Cilado Palë mund të ndërpresë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi duke i dërguar një njoftim përfundimtar me shkrim Palës tjetër;
5. Për zbatimin e kësaj Marrëveshje ngarkohen, Departamenti i Sigurisë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, së bashku me strukturat në varësi të tij dhe Bashkia Elbasan.

Nënshkruar në Tiranë, më datë________, në 4 (katër) kopje autentike në gjuhën shqipe, ku të gjitha tekstet janë identike e në përputhshmëri të plotë, ku secila pale mban 2(dy) kopje.

**PËR**
**DREJTORINË E PËRGJITHSHME**
**TË POLICISË SË SHTETIT**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT**

**Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORI

**PËR**
**BASHKINË ELBASAN**

**KRYETARI**

**Gledjan LLATJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

# Anex 1

**KARAKTERISTIKA MINIMALE**

Në vijim të kërkesave të vazhdueshme për përfshirjen e gjobave të Policëve Bashkiakë në sistemin e-Gjoba në administrim të Policisë së Shtetit ju bëjmë me dije se Departamenti për Teknologjinë e Informacionit në Policinë e Shtetit duke konsideruar përmbushjen e nevojave të bashkive dhe njëkohësisht duke ruajtur sigurinë e plotë të rrjetit informatik të Policisë së Shtetit mund të mundësojë qasjen në sistemin e-Gjoba nëse Bashkitë sigurojnë si më poshtë:

1. Infrastrukturën e sigurt të komunikimit për shkëmbimin e informacionit midis palëve me qëllim parandalimin e aksesit të paligjshëm apo manipulimin e informacionit duke përfshirë konsideruar por pa u kufizuar në Firewall dhe Filtrat e Trafikut, Enkriptimin, Protokollet e Sigurisë, Autentikimi, VPN (Virtual Private Network), si dhe përdorimi i standardeve të njohura të sigurisë si ISO 27001 etj.
2. Sigurimin e Sistemit për menaxhimin e gjobave dhe zhvillimin e webservice-ve për integrimin e E-gjoba të PSH me sistemet nën administrimin e pushtetit lokal.
3. Të drejtat dhe detyrimet e Bashkive dhe Policisë së Shtetit në çdo rast do të përcaktohen përmes marrëveshjes dy-palëshe.
4. Lidhja e bashkive me sistemin e-Gjoba të shoqërohet me një procedurë standarde të mirë përcaktuar, e cila do të jetë nëpërmjet:
   a. Integrimit të sistemeve nëpëmjet webservice me të gjithë elementët e nevojshëm të sigurisë.
   b. Përshtatja e një njësie lokale e cila do të konfigurohet nga Departamenti për Teknologjinë e Informacionit pranë DPPSH dhe duhet të ketë këto karakteristika:

| | |
|---|---|
| **Pikët min. për procesorin sipas: cpubenchmark.net**<br>**Min Proc. Rating according to: cpubenchmark.net:** | 12200 Pikë |
| **"Chipset":** | Intel ose Ekuivalent |
| **"RAM":** | 16 GB, min. DDR4 2666 MHz |
| **Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size":** | ≥ 500 GB SSD |
| **"Graphics":** | Dedicated Graphics with min. 4 GB Memory |
| **Ekrani "Display":** | 15.6" FHD LED (1920 x 1080), Anti Glare |
| **Bateria "Battery":** | Min. 60 Wh |
| **KOMUNIKIMI & MENAXHIMI** | |
| **Portat e Komunikimit "Ports":** | Min. (3) porta USB nga të cilat min. (3) USB 3.0/USB 3.1<br>(1) DP/HDMI<br>(1) Integrated Mic.<br>(1) Integrated HD Web Camera<br>(1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack |

| | |
|---|---|
| **Rrjeti "Networking":** | 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);<br>Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n);<br>Bluetooth min. V4.1; |
| **"Sound":** | Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo) |
| **Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":** | OEM Windows 10 64-bit Professional |
| **Tastiera "Keyboard":** | QWERTY |
| **"Pointing Device":** | Touch Pad |
| **Siguria "Security":** | Embedded Security TPM 2.0 |
| **AKSESORËT** | |
| **Kabëll "Power Cord":** | Po, European |
| **Ushqyesi "Recharger":** | Po |
| **"Mouse"** | Po, i të njëjtës Markë me Laptopin |
| **Çanta "Carrying Bag":** | Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë. |
| **"Recover":** | Recover Partition |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":** | 3 Vjet |

ANEX 2.

## PIKAT E KONTAKTIT

| **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit**<br>**Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan** | **Bashkia Elbasan** |
|---|---|
| Enri NDONI, Drejtor, Drejtoria e Sistemeve Departamenti për Teknologjinë e Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit Tiranë.<br>enri.ndoni@asp.gov.al, 00355682058536 | |
| Shef Sektori i Policisë Rrugore, DVP Elbasan | |

2172/2
08.05.2024

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI JURIDIK**

**Nr.** 543/1 **Prot.** **Elbasan më** 8 . 5 **. 2024**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.46 datë 30.04.2024 "Mbi miratimin e marrëveshjes midis Bashkisë Elbasan dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Majlinda Perriu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

544
03.05.2024

16

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI I BASHKISË ELBASAN**

Nr. 2173/1 Prot                                                                 Elbasan, më 02.05.2024

**VENDIM**

Nr. 47 datë 30.04.2024.

**PËR**

**Një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.123, datë 19.12.2023 dhe shtimin e numrit të punonjësve të Klubit Shumsportësh, njësi vartëse e Bashkisë**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, gërma "ç", neni 26, neni 27, neni 33, neni 54, gërma "d" dhe "dh", Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 8, si dhe të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me qëllim për të përmbushur me eficence administrimin e stadiumit "Elbasan Arena", asset I Bashkisw Elbasan, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Bashkisë Elbasan, në mbledhjen e tij të datës 30.04.2024, pasi mori në shqyrtim propozimin e Zv.Kryetares së Bashkisë Elbasan, Këshilli i Bashkisë Elbasan

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.123, datë 19.12.2023 "Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse të saj si dhe miratimin e nivelit të pagave për vitin 2024" (i ndryshuar) vetëm për sa më poshtë vijon:
    1.1. Ndryshimin e numrit maksimal të punonjësve të Administratës së Bashkisë (përfshirë funksionet e deleguara), Njësitë Administrative dhe Lagjet nga 498 në 493.
    1.2. Ndryshimin e numrit maksimal të punonjësve të Klubit Shumsportësh nga 46 në 51.
2. Për zbatimin e vendimit të Këshillit Bashkiak të ngarkohen Klubi Shumsportësh Elbasan; Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore; Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes .

**SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Elvi ÇUNI**

**K R Y E T A R**

**Lutfi LALA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

*Konc: Ermira Tafani (Këshilltare)*
*Luan Dervishi (Drejtor i DABNJ)*
*Arben Hoxha (Drejtor i Drejtorisë Juridike)*
*Miratoi: Gentjan Dyrmyshi (Drejtor i Përgjithshëm)*
*Konfirmoi: Aulona Bylykbashi (zv.Kryetar i Bashkisë)*

2173/2.
09.05.2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

**Nr.** 544/ **Prot.** **Elbasan më** 09 . 5 . **2024**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.47 datë 30.04.2024 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.123, datë 19.12.2023 dhe shtimin e numrit të punonjësve të Klubit Shumësportësh, njësi vartëse e Bashkisë", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Majlinda Perriu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, www.prefekti.elbasan.gov.al , email: prefekti.elbasan@mb.gov.al

545
03.05.2024

17

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.** 2194/1 **Prot.** **Datë** 02 **.**05 **2024**

# VENDIM

**NR.** 48 **DATË** 30 **. 04. 2024**

**MBI**

**"Transferim fonde për shpenzime, në buxhetin e vitit 2024".**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30 .04.2024, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Transferim fonde për shpenzime, në buxhetin e vitit 2024", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", "Udhëzimin plotësues nr.1, datë 24.01.2024 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.126, datë 26.12.2023, për "Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2024, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026",

**VENDOSI**

1. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2024, nga të ardhurat, për shpenzime si më poshtë :

   ***Paksohet :***

   - 2,156,000 lekë, "Shpenzime paga administrata, funksoni 01110, artikulli 600, njësia shpenzuese Bashkia.

   ***Shtohet :***

   - 2,156,000 lekë, "Pagesë e dëmshpërblimit për vjetërsi, për punonjësit e larguar, funksioni 01110, artikulli 606, njësia shpenzuese Bashkia.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Buxhet Financë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

**SEKRETAR**
**Elvi Çuni**

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

P/Sekt..Buxhetit : M.Beluli
Dr.Buxhet Finance : A.Merkja
D.P.P.A.B.F: G. Dyrmyshi
Dr.Juridike: A. Hoxha

2194/2.
09.05.2024.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**

**Nr.** 545/1 **Prot** **Elbasan, më** 08.5.**2024**

**Lënda**: Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.48, datë 30.04.2024 "Transferim fonde për shpenzime, në buxhetin e vitit 2024", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Majlinda PERRIU**

546
03.05.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2260/1 Prot.

Datë 02 .05 2024

VENDIM

NR. 49 DATË 30 . 04. 2024

MBI
"Miratim fonde për bashkëfinancim aktivitete (Kujtesë për Vazhdimësi, Viti i Normales).

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 30 .04.2024, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi "Miratim fonde për bashkëfinancim aktivitete (Kujtesë për Vazhdimësi, Viti i Normales)", bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", "Udhëzimin plotësues nr.1, datë 24.01.2024 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.126, datë 26.12.2023, për "Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2024, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026",

VENDOSI

1. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2024, nga të ardhurat, për shpenzime si më poshtë :

*Paksohet :*

- 400,000 lekë, shpenzime kuotë anëtarësie për Këshilllin e Qarkut (tepricë limiti), njësia shpenzuese Bashkia.

*Shtohet :*

- 400,000 lekë, shpenzime për aktivitete (bashkëfinancim "Kujtesë për Vazhdimësi"- Viti i Normales", njësia shpenzuese Agjencia e Kulturës dhe Turizmit.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Buxhet Financë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Elvi Çuni

KRYETARI
Lutfi Lala

P/Sekt..Buxhetit : M.Beluli
Dr.Buxhet Finance : A.Merkja
D.P.P.A.B.F: G. Dyrmyshi
Dr.Juridike: A. Hoxha

2260/2
08.05.2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

80 VJETORI I ÇLIRIMIT

Nr. 546/1 Prot

Elbasan më 8.5.2024

**Lënda**: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.49, datë 30.04.2024 "Miratim fonde për bashkëfinancim aktivitete (Kujtesë për Vazhdimësi, Viti i Normales)", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Majlinda PERRIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN